



Институт за човекови права

ZBATIMI I NJË QASJEJE TË BAZUAR  
NË TË DREJTAT E NJERIUT GJATË  
KRIZËS KOVID-19



# RAPORTI I MONITORIMIT MBI ZBATIMIN E QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT DHE KUFIZIMET QË DALIN NGA KRIZA KOVID-19

**RAPORTI I PARË I MONITORIMIT MBI ZBATIMIN E QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT  
DHE KUFIZIMET QË DALIN NGA KRIZA KOVID-19  
(PERIUDHA: PRILL - GUSHT 2021)**

**BOTUES:**

Instituti për të Drejtat e Njeriut

**AUTORI:**

DR.VESNA STEFANOVSKA

**PËRKTHEU:**

Blerina Starova Zllatku

**VENDI DHE VITI I PUBLIKIMIT:**


Shkup, shtator 2021

*Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Balkan Trust for Democracy, the German Marshal Fund Shteteve të Bashkuara, USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*

# HYRJE

Instituti për të Drejtat e Njeriut, në Prill 2021, filloi zbatimin e projektit “Zbatimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut gjatë krizës KOVID-19”, me mbështetjen e Balkan Trust for Democracy, projekt i financuar nga Gjermania nga German Marshall Fund i SHBA-së dhe USAID. Qëllimi i këtij projekti është të zbatojë Qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut (QBDNJ) gjatë krizës KOVID-19, në mënyrë që më mirë të analizohen dhe adresohen kufizimet e të drejtave të njeriut që priten gjatë një pandemie. Zbatimi i QBDNJ në zbatimin e politikave shëndetësore duhet të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në lidhje me krizën shëndetësore, të tilla si: e drejta për shëndet dhe kujdes shëndetësor, për liri të lëvizjes, e drejta për arsimim, e drejta për qasje në informacion, ndalimi i diskriminimi dhe të ngjashme.

Bashkangjitur është një retrospektivë e shkurtër e ngjarjeve më të rëndësishme që lidhen me trajtimin e krizës shëndetësore, duke filluar nga marsi 2020.

	
<b>11 mars 2020</b>	Organizata Botërore e Shëndetit shpalli pandeminë globale të koronavirusit - KOVID -19;
<b>18 mars 2020 r.</b>	Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpalli gjendjen e jashtëzakonshme për herë të parë, e cila zgjati deri më 23 qershor 2020;
<b>22 mars 2020</b>	për herë të parë, për shkak të koronavirusit, u vendos një ndalim i lëvizjes në të gjithë territorin e vendit, në një interval të caktuar kohor (nga ora 10 pasdite deri në 6 të mëngjesit të ditës tjetër);
<b>2 prill 2020</b>	Republika e Maqedonisë së Veriut aktivizoi Nenin 15 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe bëri thirrje për derogim nga të drejtat e njeriut gjatë KOVID-19.
	Cjatë gjendjes së jashtëzakonshme, qeveria miratoi 250 dekrete me fuqi ligjore që rregullojnë një gamë të gjerë çështjesh të rëndësishme për menaxhimin e krizave; <sup>1</sup>
	Cjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut veproi në lidhje me 65 nisma për të vlerësuar kushtetutshmërinë e dekreteve me fuqi ligjore;
<b>26 janar 2021 r.</b>	Qeveria e RMV miratoi Planin Kombëtar për vaksinimin kundër KOVID-19;
<b>17 shkurt 2021</b>	filloi procesi i vaksinimit kundër KOVID-19.

<sup>1</sup> Për më shumë detaje mbi llojin dhe përmbajtjen e dekreteve me fuqi ligjore, shihni: Analiza e dekreteve të miratuara me fuqi ligjore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në vitin 2020, Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike [Анализа на донесените уредби со законска сила за време на вонредната состојба во 2020\\_Блупринт.pdf \(ihr.org.mk\)](#)



## **Raporti i parë i monitorimit është përgatitur duke mbledhur informacion, si më poshtë:**

- 1) Monitorimi i aktiviteteve të Qeverisë së RMV, Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të tjera përkatëse përmes rishikimit të përditshëm të uebfaqeve të tyre, monitorimit të konferencave për shtyp në lidhje me KOVID-19, deklaratave dhe njoftimeve;**
- 2) Paraqitja e kërkesave për qasje falas në informacionin publik;**
- 3) Monitorimi i informacionit të publikuar në media që është i rëndësishëm dhe lidhet me kufizimet gjatë krizës shëndetësore.**

Raporti i parë i monitorimit mbi zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe kufizimet që dalin nga kriza KOVID-19 do të përqendrohet në të drejtën për shëndetin, të drejtën për arsim dhe lirinë e lëvizjes, si të drejtat themelore gjatë pandemisë globale, me një fokus të veçantë mbi kufizimet dhe ndikimin e tyre te qytetarët, dhe veçanërisht te grupet e marginalizuara. Një kërkesë për qasje falas në informacion iu paraqit Ministrisë së Shëndetësisë në qershor dhe korrik 2021, por nuk morëm përgjigje për pyetjet tona brenda afatit të përcaktuar me ligj.

# A)

## E DREJTA PËR SHËNDET



**E** drejta për shëndetin është një nga të drejtat themelore të para që u kërcënua gjatë kohëzgjatjes së pandemisë. Zbatimi i QBDNJ-së, në drejtim të krijimit të politikave dhe programeve për përballimin me krizën me KOVID-19, është i rëndësishëm për të mbrojtur grupet më të cenueshme në shoqëri, për të ndihmuar në luftimin e përhapjes së dezinformatave dhe për të zvogëluar nevojën për masa joproporcionale. Shumica e masave, vendimeve të Qeverisë, protokolleve të miratuara dhe informacioneve të tjera të publikuara i referoheshin mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe realizimit të interesit publik. Diskutimet që u zhvilluan në publik ishin në lidhje me justifikimin e masave dhe kufizimeve.

## TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE NË LIDHJE ME KUFIZIMIN E SË DREJTËS PËR SHËNDET

<p>Llojet e botimeve dhe institucioni që i miraton ato</p>	<p>Vendimet dhe njoftimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut</p>	<p>U mbajtën konferenca për shtyp të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komisionit për Sëmundjet Infektive</p>
<p>U sollën 16 vendime të Qeverisë së RMV nga 1 prilli 2021 në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe parandalimit të përhapjes së koronavirusit</p>		
<p>Informacione të tjera të publikuara</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aplikacioni për koronavirus MK - Informacion zyrtar për mbrojtjen dhe parandalimin e koronavirusit. Informacioni për rastet e reja të KOVID-19 publikohet çdo ditë;</li> <li>• Plani kombëtar për vaksinimin e popullatës;</li> <li>• Aplikacioni për shprehjen e interesit për vaksinim kundër KOVID-19;</li> <li>• Broshura, udhëzues, pyetje dhe përgjigje, mite dhe të vërteta (në gjuhën maqedonase dhe shqipe) në lidhje me koronavirusin, të publikuara në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë;</li> <li>• Informacioni mbi njohjen e simptomave të koronavirusit, masat e mbrojtjes, numrat e kontaktit të kujdesit shëndetësor, izolimi i duhur në shtëpi dhe informacion në lidhje me udhëtimin në vendet me rrezik të mesëm dhe të lartë janë në dispozicion në faqen e internetit të Qeverisë në seksionin Masat dhe rekomandimet për mbrojtjen dhe parandalimin e KOVID-19;</li> <li>• Masat dhe rekomandimet nga ministrinë kompetente, të disponueshme në faqen e internetit të Qeverisë;</li> <li>• Video edukative (në gjuhën maqedonase dhe shqipe) për parandalimin e përhapjes së virusit, të disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë;</li> <li>• 75 protokolle për KOVID-19 të publikuara në faqen e internetit të Qeverisë së RMV-së;</li> <li>• Rekomandimet për udhëtim që kanë të bëjnë me koronavirusin, në maqedonisht, shqip dhe anglisht, të publikuara në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë;</li> <li>• Fushata e promovuar për vaksinimin dhe luftën kundër dezinformatave, e titulluar “Për momentet e lumturisë - vaksinohu”.</li> </ul>	
<p>Disponueshmëria, afati kohor dhe kuptueshmëria e vendimeve dhe informacioneve të tjera që lidhen me KOVID-19</p>	<p>Vendimet e Qeverisë dhe ministrive të tjera përkatëse në lidhje me ushtrimin e së drejtës për shëndetësi dhe kujdes shëndetësor ishin në dispozicion të qytetarëve. Vendimet dhe informacionet, përveç maqedonishtes, botoheshin edhe në gjuhën shqipe. Konferencat për shtyp të Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komisionit për Sëmundjet Infektive, në vitin 2020, u transmetuan gjithashtu në gjuhën e shenjave.</p>	

### Informacion mbi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe marrjes së masave për parandalimin e transmetimit të koronavirusit, deri më tani Qeveria e RMV-së ka ndarë 6 pako masash kundër krizës për të mbështetur bizneset që u mbyllën plotësisht. 4 pako masash, përmes lëshimit të kartave të pagesës në vlerë prej 6,000 denarë, përfshinë prindërit e vetëm, pensionistët me pensione deri në 15,000 denarë, të papunët, artistët e pavarur dhe punëtorët kulturorë dhe studentët. 3 pako masash mbuluan persona të papunë, kategori të cenueshme shoqërore, të rinj (nxënës të shkollave të mesme, studentë dhe të rinj deri në 29 vjeç), familje me të ardhura të ulëta, personel mjekësor.<sup>2</sup>

Më 26 janar 2021, Qeveria miratoi Planin Kombëtar për vaksinimin kundër KOVID-19. Për shkak të numrit të kufizuar të vaksinave në kohën e hartimit së planit, u imponua nevoja për prioritetizim dhe nënprioritetizim<sup>3</sup>, ku janë identifikuar tre grupe të rrezikuara për vaksinimin, si më poshtë:

- 1) Personat që janë thelbësorë për t'iu përgjigjur pandemisë dhe për kujdesin dhe trajtimin e të sëmurëve (punonjës shëndetësorë);**
- 2) Personat që mbajnë shërbime thelbësore të komunitetit (infrastrukturë kritike);**
- 3) Personat të cilët janë më të rrezikuar nga komplikimet dhe vdekja.**

Shpjegimet dhe arsyetimet për përparësinë e grupeve të rrezikut për vaksinim kanë të bëjnë me rolin kritik në sigurimin, kujdesin dhe trajtimin e personave të infektuar, rrezik të lartë të ekspozimit dhe infektimit në punë. Për më tepër, si arsye për prioritetizim është dhënë mundësia e vdekshmërisë më të lartë të të moshuarit, vdekshmëria e lartë dhe vaksinimi i personave të nevojshëm për kontrollin dhe monitorimin e epidemisë, si dhe personat që janë thelbësorë për qeverisjen e shtetit dhe ruajtjen e rendit dhe paqes publike.<sup>4</sup> Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se aplikimi i QBDNJ-së luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e grupeve të rrezikut për vaksinim, në mënyrë që të respektohet parimi i mosdiskriminimit. U zhvillua një diskutim publik në lidhje me përparësinë për vaksinimin e personave me aftësi të kufizuara në fillim të procesit të vaksinimit, sepse këtyre njerëzve, kur u përcaktuan grupet e vaksinimit, nuk iu dha përparësi dhe kërkesat e tyre nuk u morën parasysh.

<sup>2</sup> Masat ekonomike të Qeverisë së RMV-së për trajtimin e pasojave të KOVID-19, *Masat ekonomike të Qeverisë | Coronavirus | Vlada.mk (koronavirus.gov.mk)*

<sup>3</sup> Plani kombëtar për vaksinimin kundër KOVID-19, i disponueshëm në: *Natsionalen-plan-za -imunizatsija.pdf (zdravstvo.gov.mk)*

<sup>4</sup> Për më shumë detaje mbi përcaktimin e grupeve të rrezikut për vaksinimin dhe prioritetizimin e tyre shihni: Plani kombëtar për vaksinimin kundër KOVID-19 i disponueshëm në: *Natsionalen-plan-za-imunizatsija .pdf (zdravstvo.gov.mk)*

# B)

## E DREJTA PËR ARSIM



**P**andemia e shkaktuar nga koronavirusi kishte një ndikim të rëndësishëm në realizimin e së drejtës për arsim në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Më 10 Mars 2020, Qeveria e RMV-së mori vendim për të përfunduar procesin arsimor në kopshte, arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Më 18 gusht të të njëjtit vit, Qeveria miratoi një vendim sipas të cilit mësimi në shkollat fillore dhe të mesme, për vitin akademik 2020/2021, do të zhvillohet në internet, me përjashtim të nxënësve nga klasa e parë deri në klasën e tretë që lejohen të ndjekin mësimet me prani fizike në klasë, në përputhje me kapacitetet e shkollave për zbatimin e planit dhe protokolleve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe me miratimin e prindërve.



## TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE QË I REFEROHEN KUFIZIMIT TË LIRISË SË LËVIZJES NË TERRITORIN E TË GJITHË VENDIT

Llojet e botimeve dhe institucioni që i miraton ato	Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut	Njoftimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
Qeveria miratoi 5 vendime, nga prilli 2021, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e procesit arsimor në kopshte, shkolla fillore dhe të mesme, si dhe në institucionet e arsimit të lartë.		
Informacione të tjera të publikuara	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 36 protokolle që lidhen me realizimin e së drejtës për arsimim nga aspekte të ndryshme</li> <li>• Udhëzime për mësimdhënësit për mënyrën e vlerësimit të nxënësve në periudhën e realizimit të mësimin, përmes mësimin në distancë, të miratuar nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit;</li> <li>• Kodi për realizimin e mësimin në distancë (i pranuar dhe i përshtatur nga shkollat);</li> <li>• Udhëzime për metodologjinë e mësimin në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm;</li> <li>• Plani për mësimdhënie në shkollat fillore dhe të mesme, në vitin shkollor 2021/2022</li> <li>• Vendimi i Qeverisë nga 17 gusht 2021, me të cilin në vitin shkollor 2021/2022 duhet të fillojë me prezencë fizike, me kapacitet të plotë, sipas protokolleve të përcaktuara dhe të miratuara;</li> <li>• Informacioni i publikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, më 21 gusht 2021, se tabletat shkollore janë siguruar dhe u janë shpërndarë nxënësve të klasës së katërt nga familje në rrezik social.</li> </ul>	
Disponueshmëria, afati kohor dhe kuptueshmëria e vendimeve dhe informacioneve të tjera që lidhen me KOVID-19	Vendimet e Qeverisë dhe informacioni i publikuar i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në lidhje me realizimin e së drejtës për arsim, ishin në dispozicion të qytetarëve. Protokollat që lidhen me procesin arsimor publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.	

Bashkangjitur është një përmbledhje e përgjigjeve të marra nga shkollat e mesme, bazuar në kërkesat e paraqitura për qasje falas në informacion, me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me kufizimet e mundshme që ndikojnë në ushtrimin e së drejtës për arsim, me zbatimin e mësimin në distancë, si më poshtë:

	<b>Shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit</b>	<b>Numri i përgjithshëm i nxënësve që ndjekin mësimin në distancë në vitin akademik 2020/2021</b>	<b>Problemet në realizimin e mësimin në distancë</b>
<b>1</b>	"Nikola Karev " - Shkup	1117 nxënës	Probleme të herëpashershme me platformën kombëtare dhe lidhjen me internetin
<b>2</b>	"Rade Jovçevski -Korçagin" - Shkup	1027 nxënës	Ata nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>3</b>	"Josip Broz Tito" - Shkup	1557 nxënës	Një numër shumë i vogël i nxënësve dhe mësimdhënësve kishin probleme me lidhjen e internetit dhe platformën kombëtare
<b>4</b>	"Mihajllo Pupin" - Shkup	861 nxënës	231 nxënës gjithashtu kishin orë me prani fizike në lëndën Orë praktike. Probleme të herëpashershme me lidhjen në internet.
<b>5</b>	"Boro Petrushevski" - Shkup	617 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>6</b>	"Orce Nikollov" - Shkup	1180 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>7</b>	"Koço Racin" - Shkup	211 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>8</b>	"Pançe Arsovski" - Shkup	379 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>9</b>	"Georgi Dimitrov" - Shkup	1281 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>10</b>	"Vasil Antevski -Dren" - Shkup	1569 nxënës	Problemet me lidhjen e dobët të internetit në disa pjesë të Shkupit dhe mungesë e pajisjes përmes së cilës nxënësi mund të ndjekë mësimet online. Shkolla mbajti 3 aksione humanitare, përmes të cilave u siguruan kompjuterë dhe tableta për nxënësit. Këshillim i vazhdueshëm me prindërit dhe nxënësit.
<b>11</b>	"Vllado Tasevski" - Shkup	1004 nxënës	Probleme të herëpashershme me lidhjen e internetit dhe platformën kombëtare.
<b>12</b>	"Dimitar Vllahov" - Shkup	458 nxënës	Ata nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>13</b>	"Vëllezërit Miladinov" - Shkup	288 nxënës	32 nxënës kanë raportuar se nuk ishin në gjendje të ndiqnin mësimin në distancë fare. Probleme periodike me platformën Microsoft Teams, lidhjen në internet dhe mungesën e pajisjeve për të ndjekur mësimin.

<b>14</b>	"Zdravko Cvetkovski" - Shkup	1114 nxënës	Probleme të herëpashershme me platformën. Disa nxënës, në varësi të vendbanimit të tyre, kishin probleme të herëpashershme me lidhjen në internet.
<b>15</b>	"Arseni Jovkov" - Shkup	1356 nxënës	27 nxënës kanë probleme me shikimin dhe nuk kanë kushte teknike për të ndjekur mësimet, kështu që ata marrin materiale të shtypura dhe / ose kërkojnë mësim me prani fizike
<b>16</b>	"Lazar Tanev" - Shkup	440 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë
<b>17</b>	"8 Shtator" - Shkup	108 nxënës	Problemet me lidhjen e internetit janë të rralla.
<b>18</b>	"Cvetan Dimov" - Shkup	1070 nxënës	Problemet në ndjekjen e mësimin në distancë janë të ndryshme, për shkak të statusit shoqëror të nxënësve, komunës ose vendbanimit, etj.
<b>19</b>	"Dr. Pançe Karagjozov" - Shkup	2405 nxënës	Nuk kanë probleme me mësimin në distancë.
<b>20</b>	"Shaip Jusuf" - Shkup	394 nxënës	3 nxënës nuk ishin në gjendje të ndiqnin mësimet në distancë fare, kështu që ata ndoqën mësimet me prani fizike, sipas protokollit. Shkolla shpërndau tableta për nxënësit, në mënyrë që mësimi të zhvillohet pa pengesa, dhe në bashkëpunim me OJQ, u siguruan karta interneti.

Pasojat e pandemisë në ushtrimin e së drejtës për arsimim mund t'i nënshtrohen një analize të hollësishme vetëm pas përfundimit të kësaj krize shëndetësore, kur të përmbledhen të dhënat në lidhje me kufizimet në ushtrimin e së drejtës për arsim. Analizat e deritanishme janë një tregues se pandemia ka një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e arsimit, qasjen në arsim për shkak të metodave të përcaktuara virtuale të ndjekjes së mësimin, duke i bërë fëmijët nga grupet e marginalizuara më të prekshëm sepse nuk gëzojnë të njëjtat kushte si nxënësit e tjerë. Sipas UNESCO-s, deri në 1.6 miliardë nxënës nga 190 vende të botës ndoqën mësimet jashtë shkollës, ndërsa 100 milionë arsimtarë dhe staf tjetër mësimdhënës u prekën nga mbyllja e institucioneve arsimore.<sup>5</sup>

5 One year into COVID-19 education disruption: Where do we stand? ([unesco.org](https://unesco.org))

# C)

## LIRIA E LËVIZJES



**L**iria e lëvizjes është një nga të drejtat themelore të njeriut, e përfshirë në shumë konventa ndërkombëtare. Pandemia e shkaktuar nga koronavirusi nxori në pah nevojën për të ndjekur kufizimet në lidhje me krizën shëndetësore përmes një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, në mënyrë që të analizohet situata, ligjshmëria, proporcionaliteti dhe justifikimi i masave të marra.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më 22 mars 2020, për herë të parë për shkak të koronavirusit, u vendos ndalimi i lëvizjes në të gjithë territorin e vendit, në një interval të caktuar kohor (nga ora 10 në mërkurë deri në 6 të mëngjesit të ditës së nesërme). Më 27 maj 2020, me një vendim të Qeverisë, në kuadër të masave zbutëse, u mor një vendim për heqjen e ndalimit të lëvizjes.

## TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE NË LIDHJE ME KUFIZIMIN E LIRISË SË LËVIZJES NË TË GJITHË VENDIN

<p><b>Llojet e botimeve dhe institucioni që i miraton ato</b></p>	<p>Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut</p>	<p>U mbajtën konferenca për shtyp të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komisionit për Sëmundjet Infektive</p>
<p><b>Numri i vendimeve të miratuara të Qeverisë së RMV-së nga prilli 2021</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 9 vendime të Qeverisë, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen dhe / ose shtrirjen e regjimit të veçantë të lëvizjes në territorin e të gjithë vendit, duke filluar nga prilli 2021, si dhe kufizimin e lëvizjes së personave që nuk janë të vaksinuar ose nuk e kanë kaluar KOVID-19 në një periudhë prej 45 ditësh.</li> <li>• Që nga 16 qershor 2021, regjimi special për lëvizjen është hequr, ndërsa më 17 gusht janë vendosur masa për ndalimin e vizitave në ambientet e hotelierisë, ngjarjeve të të gjitha llojeve dhe qendrave tregtare të mbyllura për personat që nuk kanë një certifikatë vaksinimi. Janë parashikuar kritere të veçanta për hyrjen në vend, të cilat do të zbatohen nga 1 shtatori 2021.</li> </ul>	
<p><b>Vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me lirinë e lëvizjes, nga marsi 2020</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vendimi nr.60 / 2020</b> i 14 majit 2020, i cili përcakton diskriminimin në bazë të moshës së personave, të cilëve iu është kufizuar e drejta e lëvizjes</li> <li>• <b>Vendimi U.nr.124 / 2020</b> i 20 majit 2020, sipas të cilit nuk niset procedurë për vlerësimin e Dekretit me fuqi ligjore për lëshimin e lejeve për lëvizje në kohë kur është vendosur ndalimi i lëvizjes dhe</li> <li>• <b>Vendimi U.nr.176 / 2020</b> i datës 10 qershor 2020, me të cilin hidhet poshtë nisma për vlerësimin e dekretit me fuqi ligjore për regjimin special të lëvizjes në territorin e të gjithë vendit.</li> </ul>	
<p><b>Disponueshmëria, afati kohor dhe kuptueshmëria e vendimeve dhe informacioneve të tjera që lidhen me KOVID-19</b></p>	<p>Në vitin 2020, informacionet bëheshin publike në konferencat për shtyp të Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, me përkthim në shqip dhe në gjuhën e shenjave, ndërsa në vitin 2021 u transmetuan vendimet e Qeverisë, të cilat i referoheshin ndalimit të lëvizjes në formën e njoftimeve të Qeverisë nga seancat e mbajtura, dhe sipas nevojës mbaheshin konferenca për shtyp për publikun. Vendimet, njoftimet dhe informacionet e tjera ishin të disponueshme dhe të kuptuara qartë, ndërsa objekt diskutimi ishin masat e caktuara të Qeverisë në lidhje me afatet e tyre, dmth. vonesën.</p>	

Subjekt diskutimi ishte regjimi i veçantë i lëvizjes, i cili i referohej të rinjve deri në moshën 18 vjeçe dhe kategorisë më të moshuar të qytetarëve, për të cilën Gjykata Kushtetuese vendosi se nuk ishte në përputhje me Kushtetutën. Në të njëjtën kohë, aplikimi i QBDNJ nënkupton që masat dhe kufizimet e miratuara në lidhje me kufizimin e lirisë së lëvizjes, duhet të jenë proporcionale, në interesin publik dhe të mos diskriminojnë kategori të caktuara qytetarësh, mbi çfarëdo baze.



# KONKLUSIONE MGA ZBATIMI I DERITANISHËM I QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT GJATË KRIZËS SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

**R**epublika e Maqedonisë së Veriut aktualisht po përballet me valën e katërt të koronavirusit. Nëse analizohen masat e miratuara, mund të konkludohet se ato janë të nevojshme dhe proporcionale. Sidoqoftë, politikëbërja dhe vendimmarrja nuk marrin parasysh kushtet specifike në të cilat gjenden njerëzit me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët dhe veçanërisht viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore. Në të ardhmen, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në lidhje me këto kategori qytetarësh në realizimin e së drejtës për shëndet dhe kujdes shëndetësor në kushtet e pandemisë globale. Informacioni i paraqitur për publikun nga Qeveria dhe institucionet kompetente është transparent, në kohë dhe në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut. Sa i përket ushtrimit të së drejtës për arsimim, deri më tani procesi është zhvilluar në distancë. Ka përjashtime në lidhje me mungesën e qasjes në mësim, dhe është e nevojshme të punohet në tejkalimin e tyre, në mënyrë që të gjithë nxënësve t'u sigurohet qasje e barabartë në arsim pa diskriminim.

